

Njoftim për përqendrim, me të cilin Qendra diagnostike Vila Bogatin d.o.o., Slloveni, do të fitojë kontroll mbi QENDRËN KARDIOLOGJIKE për parandalim, terapi dhe rehabilitim d.o.o., Republika e Sllovenisë (lënda nr. 08-71/2025)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 208/24), më datë 28.03.2025, në Komisionin për Mbrojtjen e konkurrencës është dorëzuar një njoftim për përqendrim me të cilin Qendra diagnostike Vila Bogatin d.o.o., me seli në Pod Skalo 4, 4260, Bled, Slloveni, fiton kontroll të vetëm mbi QENDRËN KARDIOLOGJIKE për parandalim, terapi dhe rehabilitim d.o.o., Cankarjeva ulica 60, 5000 Nova Gorica, Republika e Sllovenisë.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre afariste:

Qendra diagnostike Vila Bogatin është themeluar në vitin 1992 dhe si e tillë është qendra e parë diagnostike në Slloveni. Fillimisht, aktiviteti kryesor i tij ishte gastroenterologjia; gjatë viteve, fusha e veprimtarisë së tij është zgjeruar. Sot, njësitë e parashtruesit funksionojnë në Bled, Lubjanë dhe Novo Mesto.

Qendra diagnostike Vila Bogatin u ofron pacientëve shërbimet e mëposhtme mjekësore: gastroenterologji, urologji, kardiologji, ortopedi, rreze X dhe ultratinguj, alergologji, tirologji, klinikë për osteoporozë, dermatologji, gjinekologji dhe konsultime për ushqyerjen

Qendra diagnostike Vila Bogatin nuk ka shoqëri të lidhura me seli jashtë Sllovenisë.

Aksionarët e drejtpërdrejtë të Vila Bogatin d.o.o. janë:

Pozavarovalnica Sava d.d. (Dunajska cesta 56, 1000 Lubjanë) dhe Zavarovalnica Triglav d.d. (Mikloshiçeva cesta 19, 1000 Lubjanë) – secila me 40% të kapitalit themelor të Vila Bogatin dhe do të fitojnë kontroll indirekt mbi Shoqëritë e Synuara

Pozavarovalnica Sava është shoqëria mëmë e Grupit të Sigurimeve Sava.

Aktualisht, Grupi i Sigurimeve Sava ka katër shoqëri të regjistruara të lidhura në Maqedoninë e Veriut:

- Sava Sigurime SHA Shkup me NUAS 4778529 me veprimtari prioritare sigurime jo-jetë,
- Sava Shoqëri Pensioni SHA Shkup me NUAS 5989434 me veprimtari prioritare aktivitete të menaxhimit të fondeve,
- Sava Station SHPKNJP Shkup me NUAS 7005350 me veprimtari prioritare testim teknik dhe analizë dhe
- VITA S HOLDING SHPK Shkup me NUAS 7690088 me veprimtari prioritare tregti me shumicë e jo-specializuar.

Zavarovalnica Triglav është shoqëria përfundimtare mëmë e Grupit Triglav.

Grupi Triglav aktualisht ka katër shoqëri të lidhura të regjistruara në Maqedoninë e Veriut:

- Triglav Sigurime SHA Shkup me NUAS 4691130 me veprimtari prioritare sigurime jo-jetë,

- Triglav Sigurime Jetë SHA Shkup me NUAS 7233825 me veprimtari prioritare sigurime jetë,
- Triglav shoqëri pensioni SHA Shkup me NUAS 7344228 me veprimtari prioritare aktivitete të menaxhimit të fondeve dhe
- TRIGLAV menaxhim me pasuri të paluajtshme SHPKNJP Shkup me NUAS 7729014 me veprimtari prioritare dhënie me qira dhe menaxhim i pasurive të paluajtshme vetjake ose të marra me qira (lizing).

QENDRA KARDIOLOGJIKE për parandalim, terapi dhe rehabilitim d.o.o. në klinikën e saj kardiologjike kryen trajtime të përgjithshme kardiologjike për pacientët e saj sipas standardeve evropiane.

Bazuar në shqyrtimin paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtje dhe mendime për këtë përqendrim në Komision. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr.54, Shkup ose me e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe duhet të arrijnë në Komision brenda 10 ditëve nga data e publikimit të këtij njoftimi.

02.04.2025

Shkup